


# BURSA LULËZOJNË



# TOKA—ORGANIZATA #1 NË KOSOVË NË ZHVILLIM RINOR

## KUSH ËSHTË TOKA?

TOKA është organizatë jo-fitimprurëse që punon për zhvillimin e shkathtësive dhe mbështetjen e të rinjve duke përfshirë vajzat, të rinjtë nga zonat rurale dhe provinciale, dhe ata nga familje me kushte të vështira ekonomike. Që nga viti 2015, TOKA ka ndryshuar jetët e më shumë se 40,000 të rinjve në Kosovë përmes aktiviteteve të edukimit formal dhe jo-formal. TOKA është organizata lidere në Kosovë për vullnetarizëm, me mbi 1,000 vullnetarë të angazhuar çdo vit.

## BURSA "LULËZUJNË"

### TREGIMI 'LULI I VOCËRR'

"Luli i Vocërr" është tregimi i Migjenit, për një djalë të ri që jeton në varfëri. Në shkollë, nxënësit e tjerë luajnë me njëri-tjetrin dhe e injorojnë atë. Luli qëndron në cep të oborrit të shkollës, duke u ngrohur me rrezet e diellit dhe ndërkohë admiron këpucët e tyre të reja e të bukura. Vetëm mësuesi i tij tregon dashuri për Lulin, por megjithatë pyetja mbetet—kush do ta ndihmojë atë?

25 vjet pas përfundimit të luftës, në Kosovë ka ende shumë persona si Luli dhe Lule. Ne po lansojmë bursën 'Lulëzujnë', për t'i ndihmuar këta të rinj të lulëzojnë në potencialin e tyre të plotë në këmbim që ata të shërbejnë në komunitet

### KUSH DO TË PËRFITOJË?

- Vajzat, të rinjtë nga zonat rurale dhe provinciale, ata me vështirësi ekonomike dhe gjenerata e parë në familjen e tyre që kryejnë studimet universitare.
- Të rinjë që kanë dhënë kontribut vullnetar në komunitet.
- Duhet të jenë studentë 18+ vjeç kur marrin bursën.

### ÇFARË MBULON BURSA?

- Deri në shumën €1,000<sup>1</sup> (duke përfshirë taksat e të ardhurave personale) për çdo student/e.
- Donacione produktesh, si laptop, libra, etj.
- Fleksibilitet në shpenzimet që mbulojnë: të universitetit, jetesës, materiale akademike, shërbime shëndetësore, etj.
- Fleksibilitet në mbulueshmërinë gjeografike: mund të jetë studime në Kosovë dhe jashtë vendit.
- Praktikë në kompani të fushës së tyre të studimeve (opsionale).

<sup>1</sup> 20% e donacionit tuaj mbulon shpenzimet administrative dhe mbështetjen programore. Kjo e çon vlerën totale të çdo burse në 1,250€, që ndihmon studentët të mbulojnë tarifatat shkollore, banimin, shpenzimet shëndetësore, librat, laptopët dhe mjete të tjera të domosdoshme akademike.

<sup>2</sup> Vlerësimet do të bëhen nga TOKA dhe ekspertë të jashtëm. Për bursat e përbashkëta, donatorët ftohen të emërojnë një vlerësues në panel.

<sup>3</sup> Zbatohet një prag minimal prej €2,500. Donacionet nga SHBA, Mbretëria e Bashkuar, Franca dhe Belgjika përfitojnë zbritje tatimore. Për donacione prej €5,000+, kompanitë kosovare mund të marrin zbritje tatimore.

"VULLNETARIZMIN DUHET TA ZHVILLUJME TEK FËMIJËT TANË QË NGA MOSHA SHUMË E RE, NË MËNYRË QË ATA TA KUPTOJNË SE PAVARËSISHT MOSHËS MUND TË BËJNË DIÇKA PËR KOMUNITETIN, PËR BASHKËMOSHATARËT E TYRE DHE TË GJITHË QYTETARËT E TJERË."



VJOSA OSMANI KADRIU  
ISH-PRESIDENTE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS



### KUR FILLON SIVJET?

- Aplikimet: Qershor-Korrik 2026
- Vlerësimi i Aplikimeve: Gusht-Shtator 2026<sup>2</sup>
- Transferi i Bursës: Tetor 2026

## BURSA TË PËRBASHKËTA

Bursa të cilat dhurohen në emër të familjes, kompanisë suaj apo në bazë të kriterëve të cilat vendosen nga ju si donator.<sup>3</sup>

### KONTAKTI PËR BURSA

LULEZOJNE@TOKA-KS.ORG  
+383 49 342 514

## DHURO TANI!



GLOBAL GIVING



GAF/ZEFFY



TRANSFER BANKAR


# KATEGORITË E BURSËS NË 2025

## MEHMET GJEVORI

**2 bursa** u ndanë për studente vajza nga zona rurale, nga familja Xharra

*"Bursa 'Lulëzojnë' ka qenë një mbështetje shumë e rëndësishme për mua, sepse më ka mundësuar të blej një laptop që po e bën studimin dhe organizimin e detyrave shumë më të lehtë."*

Elsa Keriq - përfituese e bursës "LULËZOJNË x Mehmet Gjevori"




## FATLINDA DREJTA KARAHODA

**3 bursa** u ndanë për studentë në fushën e mjekësisë nga Jehona & Era Gjurgjeala

*"Bursa do të më ndihmojë të paguaj shpenzimet bazike të një studenti, si banimi, ushqimi, librat dhe materialet për provime, si dhe transporti, e po ashtu të marr pjesë në ndonjë konferencë."*

Albana Ajvazi - përfituese e bursës "LULËZOJNË x Fatlinda Drejta Karahoda"




## ISA CONSULTING GROUP

**11 bursa** u ndanë për studentë në fushat e IT-së nga Isa Consulting Group

*"Jam shumë mirënjohëse për këtë mundësi, sepse bursat e tilla motivojnë studentët të vazhdojnë rrugëtimin e tyre me më shumë besim. Mendoj se kjo bursë është një mbështetje e madhe për ne studentët që punojmë fort për të ardhmen tonë."*

Lorika Hajdari - përfituese e bursës "LULËZOJNË x Isa Consulting Group"




## INNOVATIVE SOLUTIONS

**1 bursë** është ndarë për një studente në FIEK nga Innovative Solutions

*"Bursa 'Lulëzojnë' ka qenë sinjal se vullneti i mirë sjell të mira dhe herët a vonë shpërblehet. Po ashtu, ka qenë inkurajim që të vazhdoj përpjekjet e mia për të pasur ndikim pozitiv në shoqëri."*

Kaltrina Bunjaku - përfituese e bursës "LULËZOJNË x Innovative Solutions"



## BURSA TË HAPURA

**5 bursa** u ndanë për studentë në fusha të ndryshme nga disa donatorë individualë

*"Bursa më ka lehtësuar shpenzimet dhe më ka ndihmuar të fokusohem më mirë në studime. Jam shumë mirënjohëse për këtë mundësi, sepse më ka motivuar dhe më ka mbështetur në rrugëtimin tim akademik."*

Anda Hoxha - përfituese e bursës "LULËZOJNË"

